



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 54

2001

Nëntor

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8827 datë 5.11.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për transportin ndërkombëtar rrugor”.....	1697
Ligj nr.8828 datë 5.11.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e shërbimeve bujqësore”.....	1697
Ligj nr.8829 datë 5.11.2001	Për ratifikimin e “Konventës nr.183 “Mbrojtja e amësisë, 2000” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.....	1698
Ligj nr.8830 datë 5.11.2001	Për një shtesë në ligjin nr.7796, datë 17.12.1994 “Minerar i Shqipërisë”.....	1704
Vendim i Kuvendit nr.9, datë 22.10.2001	Për caktimin e deputetëve që do të marrin pjesë në Komisionin për Deklarimin e Pasurive të të Zgjedhurve dhe të disa Drejtuesve e Punonjësve të Shërbimit Publik.....	1704

Vendim i Kuvendit nr.10, datë 22.10. 2001	Për disa plotësime në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.....	1705
Vendim i Kuvendit nr.11, datë 22.10. 2001	Për përbërjen e kryesive të disa nënkomisioneve në varësi të komisioneve të përhershme të Kuvendit.....	1705
Vendim i Kuvendit nr.12, datë 5.11.2001	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të RTSH-së.....	1706
	Deklaratë e Kuvendit.....	1707
	Rezolutë e Kuvendit.....	1708
Rregullore e Bankës së Shqipërisë,datë 7.11.2001	Për eksport- importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare.....	1709
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për vënien nën kujdestari.....	1711

**L I G J**  
**Nr. 8827, datë 5.11.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për transportin ndërkombëtar rrugor”, nënshkruar në Tiranë më datën 24.2.2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3150, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**L I G J**  
**Nr. 8828, datë 5.11.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E SHËRBIMEVE BUJQËSORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e shërbimeve bujqësore” në shumën 9 858 000 (nëntë milionë e tetëqind e tetë mijë) USD.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3151, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

## **L I G J** **Nr. 8829, datë 5.11.2001**

### **PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NR.183 “MBROJTJA E AMËSISË, 2000”” TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** **V E N D O S I:**

#### Neni 1

Ratifikohet “Konventa nr.183 “Mbrojtja e amësisë, 2000”” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3152, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

## **KONVENTA 183**

Konventa lidhur me Ndryshimin e Konventës Mbrojtja e Amësisë (Ndryshuar),1952 Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbledhur në sesionin e saj të 88-të më 30 Maj 2000, dhe

Duke vërejtur nevojën për ndryshimin e Konventës Mbrojtja e Amësisë (Ndryshuar) 1952 dhe Rekomandimit Mbrojtja e Amësisë, 1952, me qëllim që të nxisë më shumë barazinë e të gjitha grave në fuqinë punëtore dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin e nënës dhe fëmijës dhe me qëllim që të njihet diversiteti në zhvillimin ekonomik dhe social të Anëtarëve, si dhe diversiteti i ndërmarrjeve dhe zhvillimin e mbrojtjes së amësisë në legjislacionin dhe praktikën e vendit, dhe

Duke vërejtur dispozitat e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (1948), Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (1979), Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), Deklaratën dhe Platformën e Pekinit për Veprim (1995), Deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Barazinë e Shanseve dhe Trajtimit për Gratë Punonjëse (1975), Deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe Follow-up-in e saj

1698

(1998), si dhe Konventat dhe Rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, që synojnë të sigurojnë barazinë e shanseve dhe të trajtimit për burrat dhe gratë punonjëse, veçanërisht Konventën lidhur me Punonjësit me Përgjegjësi Familjare, 1981 dhe

Duke marrë parasysh rrethanat e grave punonjëse dhe nevojën për të siguruar mbrojtje për shtatzaninë, të cilat janë përgjegjësi të përbashkëta të shtetit dhe shoqërisë, dhe

Pasi vendosi për miratimin e disa propozimeve lidhur me ndryshimin e Konventës Mbrojtja e Amësisë (Ndryshuar) 1952 dhe Rekomandimit, 1952, e cila është pika e katërt e rendit të ditës së sesionit, dhe

Pasi vendosi që këto propozime të marrin formën e një Konvente Ndërkombëtare;

Miratton këtë ditë të pesëmbëdhjetë të Qershorit të vitit dymijë Konventën e Mëposhtme, e cila mund të quhet Konventa Mbrojtja e Amësisë, 2000.

## Neni 1

### Fusha

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "grua" zbatohet ndaj çdo personi të gjinisë femërore pa asnjë lloj diskriminimi dhe termi "fëmijë" zbatohet ndaj çdo fëmije pa asnjë lloj diskriminimi.

## Neni 2

1. Kjo Konventë zbatohet ndaj të gjitha grave punonjëse, duke përfshirë ato në format jo tipike të punës së varur.

2. Megjithatë, çdo Anëtar që ratifikon këtë Konventë mund, pas konsultimit me organizatat përfaqësuese të interesuara të punëdhënësve dhe punonjësve, të përjashtojë pjesërisht apo plotësisht nga fusha e Konventës kategori të kufizuara të punonjësve kur zbatimi i saj ndaj tyre do të shkaktonte probleme të veçanta të natyrës esenciale.

3. Çdo Anëtar, i cili shfrytëzon mundësinë e parashikuar në paragrafin e mësipërm duhet, në raportin e parë mbi zbatimin e Konventës, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të listojë kategoritë e punonjësve të përjashtuar dhe arsyet e përjashtimit të tyre. Në raportet e tyre të mëpasme, Anëtarët duhet të përshkruajnë masat e marra me synim shtrirjen progresive të dispozitave të Konventës ndaj këtyre kategorive.

## Neni 3

### Mbrojtja e shëndetit

Çdo Anëtar duhet, pas konsultimit me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punonjësve, të miratojë masat e përshtatshme për të siguruar se gratë shtatzëna ose me fëmijë në gji nuk janë të detyruara të kryejnë punë, të cilat janë përcaktuar nga autoriteti kompetent si të dëmshme për shëndetin e nënës ose fëmijës, ose kur një vlerësim i ka konsideruar të rrezikshme për shëndetin e nënës ose të fëmijës së saj.

## Neni 4

### Leja e barrë lindjes

1. Në bazë të një vërtetimi mjekësor ose të një vërtetimi tjetër të përshtatshëm, sipas përcaktimit nga legjislacioni dhe praktika e vendit në të cilin caktohet data e parashikuar për lindjen e fëmijës, gruaja ndaj së cilës zbatohet kjo Konventë duhet të ketë të drejtën e një leje barrë lindjeje për një kohë jo më pak se 14 javë.

2. Kohëzgjatja e lejes së lindjes, e parashikuar me paragrafin e mësipërm, duhet të përcaktohet nga çdo Anëtar në deklaratën që shoqëron ratifikimin nga ai të kësaj Konvente.

3. Çdo Anëtar mund të depozitojë më pas te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës një deklaratë tjetër për zgjatjen e periudhës së lejes së barrë lindjes.

4. Duke marrë parasysh mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës, leja e barrë lindjes duhet të përfshijë një periudhë kohe prej gjashtë javësh leje të detyrueshme pas lindjes së fëmijës, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen midis qeverisë dhe organizatave të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punonjësve.

5. Periudha e kohës së lejes së paralindjes duhet të zgjatet për një periudhë të barabartë me kohën midis datës së parashikuar për lindjen e fëmijës dhe datës aktuale të lindjes së fëmijës, pa zvogëluar kohëzgjatjen e detyrueshme të lejes së paslindjes.

#### Neni 5

### **Leja në rastet e sëmundjes ose komplikacioneve**

Në bazë të një vërtetimi mjekësor, duhet të jepet pushim para ose pas periudhës së lejes së barrë lindjes në rastin e sëmundjes, komplikacioneve ose rrezikut të komplikacioneve që shkaktohen nga shtatzania ose lindja e fëmijës. Natyra dhe zgjatja maksimale e këtij pushimi mund të përcaktohet në përputhje me ligjet dhe praktikën e vendit.

#### Neni 6

### **Përfitimet**

1. Gratë që mungojnë në punë për shkak të lejes së barrë lindjes ose pushimit të parashikuara në nenet 4-5 duhet të përfitojnë të ardhura në të holla në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit ose, në çdo mënyrë tjetër, në përputhje me praktikën e vendit.

2. Të ardhurat në të holla duhet të jenë në një nivel që siguron se gruaja mund të mbajë veten dhe fëmijën e saj në kushte të përshtatshme për shëndetin dhe në një standard të përshtatshëm jetese.

3. Në rastin kur, sipas legjislacionit ose praktikës së vendit, të ardhurat në të holla që paguhen lidhur me lejen e parashikuar në nenin 4 bazohen në të ardhurat e mëparshme, masa e këtyre të ardhurave nuk duhet të jetë më e vogël se dy të tretat e të ardhurave të mëparshme të gruas ose të atyre të ardhurave që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e të ardhurave të barrë lindjes.

4. Në rastin kur, sipas legjislacionit ose praktikës së vendit, janë përdorur metoda të tjera për të caktuar të ardhurat në të holla, që paguhen lidhur me lejen e parashikuar në nenin 4, masa e këtyre të ardhurave duhet të jetë e krahasueshme me mesataren e të ardhurave të llogaritura sipas paragrafit të mësipërm.

5. Çdo Anëtar duhet të sigurojë që kushtet për përfitimin e të ardhurave duhet të plotësohen nga masa më e madhe e grave ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë.

6. Kur gruaja nuk plotëson kushtet për përfitimin e të ardhurave sipas ligjeve dhe rregullave të vendit ose sipas ndonjë mënyre tjetër në përputhje me praktikën e vendit, duhet të ketë të drejtë për të ardhura të përshtatshme nga fondet e asistencës sociale, me rezervën e kontrollit të mjeteve të jetesës që kërkohet për përfitimin e kësaj asistence.

7. Përfitimet mjekësore duhet të sigurohen për gruan dhe fëmijën e saj në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit ose në një mënyrë tjetër, në përputhje me praktikën e vendit. Përfitimet mjekësore duhet të përfshijnë kujdesin e paralindjes, gjatë lindjes dhe pas lindjes, si dhe kujdesin spitalor, kur është i nevojshëm.

8. Me qëllim që të mbrohet pozita e gruas në tregun e punës, të ardhurat lidhur me lejen e parashikuar në nenin 4 dhe 5 duhet të sigurohen nga fondet e sigurimit shoqëror të detyrueshëm ose publik, ose në një mënyrë të përcaktuar nga ligji dhe praktika e vendit. Punëdhënësi nuk duhet të jetë përgjegjës individualisht për koston e drejtpëdrejtë të këtyre të ardhurave që përfiton gruaja e punësuar nga ai ose ajo, pa miratimin e shprehur të tij, përveç kur:

a) kjo është parashikuar në ligjin ose praktikën e një Shteti anëtar para datës së miratimit të kësaj Konvente nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës; ose

b) më vonë është rënë dakord në nivel vendi nga qeveria dhe organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punonjësve.

## Neni 7

1. Anëtari, ekonomia dhe sistemi i sigurimit shoqëror i të cilit janë të zhvilluara pamjaftueshmërisht supozohet se është në pajtim me nenin 6 paragrafi 3 dhe 4, nëse të ardhurat në para sigurohen në një vlerë jo më të vogël se vlera që paguhet për sëmundjen ose paaftësinë e përkohshme, në përputhje me ligjet dhe praktikën e vendit.

2. Anëtari që shfrytëzon mundësinë e parashikuar në paragrafin e mësipërm duhet, në raportin e tij të parë mbi zbatimin e kësaj Konvente sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të sqarojë arsyet përkatëse dhe të tregojë vlerën e të ardhurave në para që sigurohet. Në raportin e tij të mëvonshëm, Anëtari duhet të përshkruajë masat e marra me synim rritjen progresive të vlerës së të ardhurave.

## Neni 8

### **Mbrojtja e punësimit dhe mosdiskriminimi**

1. Është e paligjshme për punëdhënësin të pushojë nga puna gruan gjatë kohës së shtatzanisë ose mungesës në punë për shkak të lejes së parashikuar në nenet 4 ose 5, ose gjatë një periudhe të caktuar pas kthimit të saj në punë, që duhet përcaktuar nga ligjet ose rregullat e vendit, përveç shkaqeve që nuk lidhen me shtatzaninë ose lindjen e fëmijës dhe pasojat e saj ose ushqimin e fëmijës. Bara e provës se arsyet e pushimit nga puna nuk lidhen me shtatzaninë ose lindjen e fëmijës dhe pasojat e saj ose ushqimin e fëmijës bie mbi punëdhënësin.

2. Pas përfundimit të lejes së barrë lindjes, gruaja duhet të sigurohet që, me rimarrjen e punës, do të gjejë të njëjtin vend pune ose një vend pune ekuivalent me pagë të njëjtë.

## Neni 9

Çdo Anëtar duhet të miratojë masat e nevojshme për të siguruar se barrë lindja nuk përbën burim për diskriminimin në punë, duke përfshirë, përveç sa parashikohet në nenin 2 paragrafi 1, pranimin në punë.

3. Masat e parashikuara në paragrafin e mësipërm duhet të përfshijnë ndalimin e kërkesës për kontrollin e shtatzanisë ose të një vërtetimi për këtë kontroll, kur gruaja paraqet kërkesën për punë, përveç kur kërkohet nga ligjet ose rregullat e vendit lidhur me punën:

a) e cila është e ndaluar ose e kufizuar për gratë shtatzëna ose me fëmijën në gji, sipas ligjeve ose rregullave të vendit;

b) në të cilën ekziston një rrezik i njohur ose i dukshëm për gruan ose fëmijën.

## Neni 10

### **Nënat me fëmijë në gji**

1. Gruas duhet t'i sigurohet e drejta për një apo më shumë pushime gjatë kohës ditore të punës ose zvogëlim i orëve ditore të punës për t'i dhënë gji fëmijës së saj.

2. Periudha gjatë së cilës jepen pushimet për dhënie gji të fëmijës ose zvogëlimi i orëve të punës, numri i tyre, kohëzgjatja e ushqimit të fëmijës dhe procedurat për zvogëlimin e orëve ditore të punës duhet të përcaktohen nga ligji dhe praktika e vendit. Këto pushime ose zvogëlim të orëve ditore të punës duhet të llogariten si kohë pune dhe, si pasojë, të paguhet.

## Neni 11

### **Shqyrtimi periodik**

Çdo Anëtar duhet të shqyrtojë periodikisht, në konsultim me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punonjësve, përshtatshmërinë e zgjatjes së periudhës së lejes së parashikuar në nenin 4 ose të rritjes së masës së vlerës së të ardhurave në para të parashikuara në nenin 6.

Neni 12  
**Zbatimi**

Kjo Konventë do të zbatohet nëpërmjet ligjeve dhe rregullave, përveç për sa i është dhënë fuqi nëpërmjet mjeteve të tjera, si marrëveshjeve kolektive, vendimeve të arbitrimit, vendimeve të gjykatës ose nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër, në përputhje me praktikën e vendit.

Neni 13  
**Dispozita të fundit**

Kjo Konventë ndryshon Konventën Mbrojtja e Amësisë (ndryshuar), 1952.

Neni 14

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 15

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i të cilëve është regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

2. Ajo hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimet e dy Anëtarëve janë regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, Konventa do të hyjë në fuqi për çdo anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 16

1. Anëtari që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pas kalimit të dhjetë vjetëve nga data e hyrjes në fuqi për herë të parë të Konventës, me anën e një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky denoncim nuk do të hyjë në fuqi deri një vit pas datës në të cilën është regjistruar.

2. Çdo Anëtar, që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen brenda një viti pas mbarimit të periudhës dhjetëvjeçare të parashikuar në paragrafin e mësipërm, do të jetë i lidhur me detyrimet për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe, pas kësaj, mund të denoncojë këtë Konventë pas kalimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen.

Neni 17

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet të njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit që i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'u kujtojë Anëtarëve të Organizatës datën në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 18

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë për regjistrim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me nenin 102 të Kartës së 1702



Kombeve të Bashkuara, të gjitha veçoritë e të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit të regjistruara nga ai, në përputhje me dispozitat e neneve të mësipërm.

#### Neni 19

Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme, sa herë që e gjykon të nevojshme, një raport mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe të shqyrtojë nevojën e vendosjes në rendin e ditës të Konferencës të çështjes së ndryshimit të saj të plotë apo të pjesshëm.

#### Neni 20

1. Kur Konferenca miraton një konventë të re që ndryshon këtë Konventë pjesërisht apo plotësisht, atëherë, përveç kur Konventa e re parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një Anëtar i Konventës së re që ndryshon këtë Konventë sjell, ipso jure, denoncimin e kësaj Konvente, pavarësisht nga kërkesat e nenit 16 më sipër;

b) nga data kur Konventa e re hyn në fuqi, kjo Konventë do të pushojë së qeni e hapur për ratifikim nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi, në çdo rast, në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale, për ata Anëtarë që e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën që e ndryshon atë.

#### Neni 21

Versionet anglisht dhe frëngjisht të tekstit të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.

### L I G J

Nr. 8830, datë 5.11.2001

#### PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7796, DATË 17.12.1994 “MINERAR I SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh

#### K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

#### Neni 1

Pas pikës b) të nenit 69 të ligjit nr.7796, datë 17.12.1994 “Minerar i Shqipërisë” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në raste të veçanta, kur afati i dhënies së lejes minerare të shfrytëzimit kërkohet deri në 99 vjet, ministria përkatëse negocion marrëveshjen me lejekërkuuesin, miratimin e së cilës e bën Këshilli i Ministrave.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të miratohet edhe nga Kuvendi.”.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3153, datë 16.11.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**V E N D I M**  
**Nr. 9, datë 22.10.2001**

**PËR CAKTIMIN E DEPUTETËVE QË DO TË MARRIN PJESË NË KOMISIONIN PËR  
DEKLARIMIN E PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE  
E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik” dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

I. Në përbërje të Komisionit për Deklarimin e Pasurive të të Zgjedhurve dhe të disa Drejtuesve e Punonjësve të Shërbimit Publik janë këta deputetë :

1. Ejup Tabaku
  2. Fatmir Xhafa
  3. Engjëll Bejtja
  4. Ilirjan Berzani
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr. 10, datë 22.10. 2001**

**PËR DISA PLOTËSIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE  
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 24, 25 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

- I. Në përbërje të komisioneve të përherëshme të Kuvendit:
- 1) Zoti Banush Gozhdari caktohet anëtar në Komisionin e Përherëshëm të Punës dhe të Çështjeve Sociale, duke zëvendësuar ish-deputetin Theodhori Bej.
  - 2) Zoti Stefan Çipa caktohet anëtar i Komisionit të Përherëshëm të Arsimit, Kulturës, Shkencës dhe Sportit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr. 11, datë 22.10.2001**

**PËR PËRBËRJEN E KRYESIVE TË DISA NËNKOMISIONEVE NË VARËSI TË  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 24, 25 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dhe të Komisionit të Përhershëm të Punës dhe të Çështjeve Sociale,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

I. Në përbërje të kryesive të nënkomisioneve në varësi të Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit:

- 1) Zoti Mezan Malaj zgjidhet Kryetar i Nënkomisionit të Kontrollit Buxhetor.
- 2) Zoti Dashmir Shehi zgjidhet Kryetar i Nënkomisionit të Reformës së Privatizimit.

II. Në përbërje të kryesive të nënkomisioneve në varësi të Komisionit të Përhershëm të Punës dhe të Çështjeve Sociale:

- 1) Zonja Fatbardha Shabanaj zgjidhet Kryetare e Nënkomisionit për Shanse të Barabarta.
- 2) Zoti Rahmi Mehmetllari zgjidhet Kryetar i Nënkomisionit për Probleme të Emigracionit.
- 3) Zoti Ilirjan Berzani zgjidhet Zëvendëskryetar i Nënkomisionit për Probleme të Emigracionit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr. 12, datë 5.11.2001**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË**

Në mbështetje të neneve 88 dhe 89 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

- I. Zoti Leka Bungo zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## DEKLARATË

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- duke ndjekur me vëmendje të gjitha zhvillimet pozitive në ish-Jugosllavi, pas rënies së regjimit diktatorial të Milosheviçit dhe fillimit të një epoke të re në Kosovë, nën administrimin dhe vëzhgimin e institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare;

- duke i konsideruar zgjedhjet parlamentare si një moment tepër i rëndësishëm i shprehjes së vullnetit të popullit të Kosovës për vetëqeverisje, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar dhe në bashkëveprim të ngushtë me faktorët globalë;

- duke vlerësuar zhvillimin me sukses të zgjedhjeve vendore të vitit 2000 dhe progresin në drejtim të rritjes së besimit, sigurisë e bashkëjetesës midis shumicës shqiptare dhe grupeve të tjera etnike;

- duke konstatuar ndjenjën e lartë të përgjegjësisë e seriozitetit, si dhe angazhimin e klasës politike vendase për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe krijimin e një shoqërie multietnike;

- duke u inkurajuar nga zhvillimi i një procesi parazgjedhor dinjitoz, të civilizuar dhe demokratik nga të gjitha forcat politike dhe komuniteti ndërkombëtar në Kosovë, për krijimin e një klime demokratike dhe të kushteve për pjesëmarrjen në zgjedhje të të gjitha grupeve politike dhe etnike;

Shpreh besimin se:

Zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit, si zgjedhje demokratike e pluraliste në Kosovë, do të zhvillohen në një klimë të qetë, me pjesëmarrje masive të të gjitha grupeve përfaqësuese në Kosovë.

Rezultatet e këtyre zgjedhjeve do të jenë të pranueshme nga grupimet politike dhe etnike pjesëmarrëse në këtë proces dhe të vlerësuara nga institucionet ndërkombëtare si të lira dhe të ndershme.

Zgjedhjet parlamentare do të çojnë në krijimin e një Kuvendi pluralist e multietnik, si hapi i parë drejt krijimit të stabilitetit politik e ndërtimit të institucioneve demokratike të qëndrueshme, të aftë për të shprehur dhe ndërtuar të ardhmen europiane të Kosovës dhe partner legjitim në marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare.

Realizimi me sukses i këtyre zgjedhjeve do të jetë një hap i rëndësishëm i faktorit shqiptar drejt stabilizimit, rritjes së sigurisë, paqes e bashkëpunimit në Rajon dhe përshpejtimin të procesit të integritetit të vendeve të Rajonit në strukturat europiane dhe euroatlantike.

Tiranë, më 5.11.2001

## REZOLUTË

### E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MBËSHTETJE TË PROCESIT DHJETËVJEÇAR TË RISTRUKTURIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi u njoh me planin dhe strategjinë dhjetëvjeçare të ristrukturimit të Forcave të Armatosura, i cili është në përputhje me mundësitë reale të vendit, kapacitetet e nevojshme për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve të mundshme, si dhe qëllimin strategjik për integrim të plotë të vendit në NATO dhe në strukturat e tjera Euroatlantike, hartuar nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vëren se dokumenti:

- mbështetet në një analizë të thellë dhe shumëdimensionale të mjedisit të ri të sigurisë në vend, rajonin e Europës Juglindore, hapësirën Euroatlantike dhe më gjerë;

- trajton në mënyrë të plotë dhe realiste gamën e rreziqeve dhe kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme për sigurimin kombëtar për dhjetëvjeçarin në vazhdim;

- merr në konsideratë, në mënyrë tepër realiste, zhvillimin dhe mundësitë ekonomike të vendit në dhjetëvjeçarin në vazhdim, me qëllimin e përballimit të kostos së transformimit të Forcave të Armatosura;

- shpreh angazhimin konkret të Forcave të Armatosura për dhjetëvjeçarin 2001-2010, duke paraqitur në mënyrë të detajuar dhe analitike zhvillimet e pritshme në fushën e sigurisë dhe duke i përqsuar këto me ecurinë e proceseve integruese të vendit;

- institucionalizon qartë misionin e ri të Forcave të Armatosura, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese për krijimin e mjedisit të sigurisë kombëtare, jo vetëm në kuadër të misionit klasik të garantimit të pacenueshmërisë së sovranitetit dhe të integritetit të vendit, por dhe në përmbushjen e detyrimeve në mbrojtje të rendit kushtetues, përballimin e emergjencave civile dhe katastrofave natyrore;

- përfaqëson një koncept të ri strategjik, i cili përputhet me zhvillimet ndërkombëtare, veçanërisht pas ngjarjeve të fundit me bazë terrorizmin.

Duke marrë në konsideratë këta faktorë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- mbështet strategjinë e realizimit të projektit të ristrukturimit, si një ndërmarrje e madhe me karakter kombëtar, e cila do të krijojë një strukturë të re të Forcave të Armatosura, më të vogël numerikisht, por më të aftë profesionalisht, për të përmbushur detyrimet kushtetuese;

- angazhohet të mbështesë të gjitha iniciativat e nevojshme ligjore për të bërë ndërhyrjet e duhura, me qëllim garantimin ligjor të këtij procesi dhjetëvjeçar, të cilat afrojnë njëkohësisht realizimin e tij me qëllimet dhe strategjinë integruese të vendit në strukturat dhe institucionet Euroatlantike.

- garanton vazhdimësinë e këtij procesi, në përputhje me normat dhe rregullat e funksionimit të një shoqërie demokratike;

- merr përsipër bashkërendimin e përpjekjeve të tij me ato të ekzekutivit për ta konsideruar procesin e ristrukturimit të Forcave të Armatosura si një prioritet kombëtar të dhjetëvjeçarit në vazhdim, si dhe kontrollin e vazhdueshëm mbi to dhe mbi të gjitha institucionet që kanë angazhim të drejtpërdrejtë, për të realizuar në mënyrë sa më të plotë detyrimet për ecurinë normale të këtij procesi;

- angazhon Komisionin Parlamentar të Mbrojtjes dhe atë të Politikës së Jashme të ndjekin në mënyrë permanente dhe të informojnë mbi ecurinë e realizimit të procesit të ristrukturimit të Forcave të Armatosura.

Tiranë, më 8.11.2001

## **RREGULLORE** **PËR EKSPORT-IMPORTET E KARTËMONEDHAVE DHE TË MONEDHAVE** **METALIKE SHQIPTARE**

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të nenit 34 kreu V të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë.”

### **KREU I** **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1** **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kritere për sasinë dhe procedurat për:

a) eksport - importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor;

b) nxjerrjen dhe sjelljen nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor.

Neni 2  
**Përkufizime**

Sa herë që përdoren në këtë rregullore, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Kartëmonedhë” është biletë banke e emetuar nga Banka e Shqipërisë dhe që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. “Monedhë” është monedha metalike e emetuar nga Banka e Shqipërisë dhe që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. “Kurs ligjor” kupton detyrimin ligjor për të pranuar kartëmonedhat dhe monedhat metalike, që nuk janë tërhequr nga qarkullimi për të gjitha pagesat e detyrimeve publike e private pa kufizim, me vlerën e tyre nominale.
4. “Cash” është kartëmonedha dhe monedha metalike në qarkullim (që nuk është tërhequr nga qarkullimi me akte nënligjore të Bankës së Shqipërisë), që eksportohet dhe importohet apo nxirret e sillet nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë fizikisht.
5. “Eksport” është nxjerrja në cash nga territori i Republikës së Shqipërisë e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, që kanë ose jo kurs ligjor, për veprimtari shitjeje për qëllime numizmatike.
6. “Import” është futja në cash në territorin e Republikës së Shqipërisë e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor.
7. “Person” është çdo person fizik dhe juridik, që është i njohur për të kryer veprimtari shitblerjeje në fushën e numizmatikës.
8. “Individ” kupton çdo shtetas shqiptar ose të huaj, rezident ose jorezident.

**KREU II  
EKSPORT-IMPORTI**

Neni 3

Banka e Shqipërisë është institucioni i njohur nga ligji, që importon dhe eksporton kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor. Sasia dhe procedurat për importet dhe eksportet që ajo kryen përcaktohen nga vetë Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Importi i kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë.

Neni 5

Në mbështetje të nenit 3 të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë realizon shitje të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë ose jo kurs ligjor, për qëllime numizmatike, duke shitur në sportelet e saj, por edhe duke i eksportuar në drejtim të blerësit të vendit të huaj, në përputhje me rregullat procedurale dhe për sasi të miratuara prej saj.

Neni 6

Banka e Shqipërisë autorizon të eksportojnë, për qëllime numizmatike, kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, edhe persona të tjerë që janë ligjërisht të njohur për të kryer veprimtari shitblerjeje në fushën e numizmatikës.

Neni 7

Në zbatim të nenit 6 të kësaj rregulloreje, autorizimi për të eksportuar jepet me shkrim dhe

vetëm për sasitë e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, të blera në Bankën e Shqipërisë.

#### Neni 8

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të hequra nga qarkullimi (që nuk kanë kurs ligjor), janë lirisht të eksportueshme.

### KREU III NXJERRJA DHE SJELLJA NGA JASHTË SHETIT E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE, QË KANË KURS LIGJOR

#### Neni 9

çdo individ lejohet të marrë me vete dhe të nxjerrë në cash nga territori i Republikës së Shqipërisë kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, në shumën deri në 50.000 ( pesëdhjetë mijë ) lekë.

#### Neni 10

Individët, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të sjellin në cash kartëmonedha e monedha metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, në shumën deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë ) lekë.

### KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 11

Rregullorja “Për nxjerrjen dhe sjelljen nga jashtë shtetit të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, që kanë kurs ligjor, e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.34, datë 2.5.2001, shfuqizohet.

#### Neni 12

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 83, datë 7.11. 2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS  
Shkëlqim Cani**

### **V E N D I M (I SHKURTUAR)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Korçës, me vendimin nr.1487, datë 25.9.2001, ka vendosur heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Marigo Gaqo Shtika, e datëlindjes 1933, dhe vënien e saj nën kujdestari të përkohshme të nipit të saj Leonard Kopali.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.11.2001  
Doli nga shtypi më 27.11.2001

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë